

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Pizza Mia” sh.p.k**

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 18/01/2021, Themeluesi:

1. **Lavderim Mexhit Sulaj**, lindur në Tirane me 27/07/1979, banues në Tirane, Kashar mbikalimi rinasit, rr. Vaso Pasha shtëpi priavte nr.32 me leternjoftim nr personal **H90727079R**.

Deklaron se ka vendosor të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë refereruar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

**Neni 1-Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë është

**“Pizza Mia” sh.p.k**

**Emri tregtar i shoqërisë : “Pizza Mia” SHPK**

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

**Neni 2-Vëndndodhja e selisë**

**Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet: Tirane Rruga "Blloku 50 Vjetori", Pallati Nr.3, Shkalla 5, Kati 1, Ap.34**

### **Neni 3- Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Qendren Kombetare të Rregjistrimit.

### **Neni 4- Objekti i veprimtarisë**

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

**1. Në fushën e tregtisë shoqëria do të kryejë: Bar-Kafe, Restorant.**

### **Neni 5- Kapitali Themeltar**

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (Njeqind ) leke.**

Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (nje) pjesë kapitali me vlerë nominale 100 (njeqind) leke.

### **Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar**

**1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (Njeqind) leke.**

Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (nje) pjesë kapitali me vlerë nominale 100 (njeqind) leke.

Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:

Kapitali i mesiperm është nënshkruar dhe shlyer teresisht në të holla nga ortakët i shoqërisë përkatësisht:

1. **Lavderim Mexhit Sulaj**, lindur në Tiranë me 27/07/1979, banues në Tiranë, Kashar mbikalimi rinasit, rr. Vaso Pasha shtepi privat nr.32 me letërnjoftim nr personal **H90727079R**, vlera e kapitalit të përgjithshëm **100 Leke**, numri i pjesëve 1, që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqesohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët përgjigjet për humbjet e shoqërisë kundrejt të tjerëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë

### **Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit**

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

### **Neni 8- Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
2. **Administratori i shoqërisë është Z. Lavderim Mexhit Sulaj**, lindur në Tirane me 27/07/1979, banues në Tirane, Kashar mbikalimi rinasit, rr. Vaso Pasha shtëpi priavte nr.32 me leternjoftim nr personal **H90727079R me nje afat 2- vjecar deri me daten 18/01/2023.**
3. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në regjistrin tregtar.

### **Neni 9- Të tjera**

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### **Neni - 10**

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

### **Neni - 12**

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

*Parë dhe miratuar në Tirane , më 18/01/2021.*

## **ORTAKU E SHOQERISE**

**Lavderim Sulaj**

*Lavderim Sulaj*

*LS*